



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.112 dt.28.09.2001

**PER  
KRIJIMIN E KESHILLIT TE KUJDESTARISE PRANE BASHKISE SE  
TIRANES**

Mbështetur në Nenin 32, gërma k, të Ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në Ligjin Nr.8654 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë së Tiranës”, në Nenet 350-357 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe në Nenin 104 të Kodit të Familjes, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratohet ngritjen e Këshillit të Kujdestarisë pranë Bashkisë së Tiranës, në përbërje të të cilit janë 5 anëtarë
  - Kryetari (jurist, Drejtor i Drejtorisë Juridike të Bashkisë Tiranë)
  - 2 anëtarë (2 këshilltarët Znj. Ana Misha dhe Z. Altin Goxhaj)
  - 2 anëtarë (punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore & Informacionit)
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Njerëzore dhe Informacionit për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**



